


"PRISHTINA ENERGJETIKE"



Projekti "Lagja e Spitalit 4-1"

"Lagja e Spitalit 4-1" është projekt në kuadër të megaprojektit investiv në rajonin e Prishtinës.

Plani investues i KEDS në Prishtinë përfshin rritjen e kapaciteteve të linjave ekzistuese nga 10 kV në 20 kV, krijimin e linjave alternative, futjen nën tokë të 90% të rrjetit të tensionit të mesëm, zëvendësimin e 50% të linjave të tensionit të ulët. Nga këto investime do të përfitojnë direkt 90 mijë konsumatorë.

Të dhëna specifike për projektin: *Largimi i 134 shtyllave ekzistuese dhe vendosja e 91 shtyllave të reja. Hapja e kanaleve të reja në shtrirje prej 4.8 km. Do të përfshihet 1 transformator, vendosja e 12.5 km kablllove të reja të tensionit të ulët.*

Përfitues nga projekti "Lagja e Spitalit 4-1" : 211 konsumatorë

Lokacionet ku do të punohet: Rr. Mehmet Shpendi; Rr. Qazim Bajraktari; Rr. Visar Thaçi dhe Rr. Malush Kosova.

Periudha e zhvillimit të projektit: 2020 – 2021

Përfundimi i projektit: Korrik 2021

Gjatë zhvillimit të punimeve konsumatorët do të informohen paraprakisht 24-48 orë përmes uebfaqes, rrjeteve sociale dhe aplikacionit eKesco.

